

ANILA OMARI

NGA FILLIMET E SHKRIMIT SHQIP TE IDEJA E NJË GJUHE TË PËRBASHKËT LETRARE SHQIPE

Për të arritur te fillimet e shkrimit shqip, në shekullin XVI, gjuha shqipe ka kaluar përmes ndikimeve kulturore të ndryshme, sipas pushteteve që qeverisnin në territoret shqipfolëse. Këto ndikime, të shprehura përmes gjuhëve zyrtare dhe kulturore që përdorshin në trojet shqiptare, nuk mund të mos kenë lënë gjurmë në zhvillimin e shqipes së folur, në rrugën e saj drejt aftësimit për t'u bërë gjuhë e shkruar. Prandaj, në pjesën e parë të këtij artikulli, do të hedhim një vështrim mbi gjuhën apo gjuhët zyrtare që përdorshin në trojet shqiptare para kësaj periudhe, duke u përpjekur të zbulojmë edhe ndonjë të dhënë të tërthortë për përdorimin e gjuhës shqipe si gjuhë e folur.

Siç e dimë nga studimet për Mesjetën shqiptare, në fund të shekullit XII ishte krijuar një strukturë shtetërore në trevën e Arbërit, me qendër në Krujë, e cila është quajtur "Principata e Arbërit" sipas titullit të marrë prej njërit prej krerëve të saj, Dhimitrit, në vitin 1208. I themeluar nga i ati i këtij, Progoni, në periudhën e sundimit të Dhimitrit Principata arriti kulmin e zhvillimit dhe qëndrueshmërisë së saj si formacion shtetëror, i ngjashëm me modelet feudale evropiane të kohës. Në këtë vështrim Principata ka pasur edhe kancelarinë e vet, si një zyrë e domosdoshme e një qeveritari, përgjegjëse për korrespondencën dhe dokumentacionin zyrtar. Gjuhët e përdorura për komunikimin zyrtar të Principatës së Arbërit ishin gjuhët ndërkombëtare të mesjetës, latinishtja mesjetare si *lingua franca* e kulturës, e shkencës dhe e marrëdhënieve ndërkombëtare të botës perëndimore, dhe greqishtja mesjetare, si gjuhë e Perandorisë bizantine, pjesë e të cilës ishte, deri në vitin 1204¹, edhe shteti i Arbërit. Këto dy gjuhë takoheshin pikërisht në këtë zonë të Ballkanit perëndimor ku shtrihej Principata e Arbërit, në kufirin e quajtur "linja e Jireçekut" sipas historianit të shquar medievist çek².

¹ Mbas Kryqëzatës IV në vitin 1204, Venediku dhe pjesëmarrësit e tjerë në Kryqëzatë nënshkruan "Traktatin e ndarjes së tokave", në të cilin parashikohet që një pjesë e mirë e bregdetit shqiptar, prej Durrësit deri në Prevezë, të kalonte nga sundimi i Perandorisë Bizantine nën atë të Venedikut, shih: S. Anamali et. al., *Historia e popullit shqiptar*, I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Toena, Tiranë, 2002, f. 231.

² Khs. për vijën e ashtuquajtur "Jireček" K. Jireček, *Historia e serbëve*, Sh.B. 55, Tiranë, 2010, f. 54.

Në Shqipërinë Qendrore bashkëjetonin edhe kulturat dhe besimet fetare që përfaqësonin këto dy gjuhë: tradita bizantine që vazhdonte të ekzistonte në përdorimin e shkrimit në greqisht dhe në titujt bizantinë brenda mjediseve katolike³ dhe ndikimi latin që vinte nga perëndimi dhe nga veriu dalmato-adriatikas. Kufiri i ndikimit të dy botëve zhvendosej herë më në veri, herë më në jug, sipas përfshirjes së këtyre krahinave nën Perandorinë bizantine ose nën fuqitë perëndimore të Evropës. Dëshmi tipike për këtë bashkëjetesë ndikimesh është mbishkrimi dygjuhësh, latinisht e greqisht, i varrit familjar të sebastit Mihal Sguro në kishën e Shën Mërisë së Brrarit. Titullari i varrit mban një titull bizantin, pra është nën varësinë e administratës së Bizantit, ndërsa varri ka arkitekturë latine dhe gjendet në një kishë katolike-romane⁴.

Mbishkrimi greqisht i varrit i vitit 1201 sipas transkriptimit, leximit greqisht dhe përkthimit shqip të studiuesve të tij A. Meksi – D. Komata:

MNHΣΘHTIK(YPI)ETONΔOYΛONΣOYMIXAHΛΣEBAΣTONTON
 NΣΓOYPOHAMAΣYMBIQIKAITEKH/OIΣ/AM/HN

9<<←Φη094 5(·Δ4)γ ϑ < *≅→8T< Φ≅→ 94ΠV←←8 Φγ∃VΦ9 < ϑ <
 E(≅→Δ≅< □:V ΦΛ:∃4™4 6Vϱ 9E/6</≅4Φ, Y:←←

*Kujto o zot shërbëtorin tënd sevastin
 Mihail Sguron me bashkëshorten e tij
 Dhe fëmijët – Viti 6709, indikti 10.*⁵

Nën këtë mbishkrim gjendet mbishkrimi latinisht me të njëjtën përmbajtje, me përjashtim të datës.

MEMENTO D(OMI)NE FAMULO TUO MICHAEL SEVASTO
 SGURU CUM UXOR SUA ET CUM FILIS SUIS.⁶

Nga letërkëmbimi zyrtar i Principatës së Arbërit kemi të dhëna për dy dokumente që mbajnë autorësinë e Dhimitrit të Arbërit. Kronologjikisht dokumenti më i hershëm është i vitit 1208, me anë të të cilit Dhimitri i kërkon papës Inocenti III ta pranonte atë dhe popullin e tij në kishën e Romës⁷, pra të largohej nga ortodoksia dhe të kalonte në katolicizëm, me qëllim për të

³ M. Sufflay, *Die Kirchenzustände in vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchszone im Katholischen Damme*, në: “Illyrisch-albanische Forschungen”, München, 1916, f. 237 vv.

⁴ I. Zamputi, *Dy mbishkrimet e fillimit të shek. XIII dhe lidhjet e tyre me principatën e Arbërit*, “Hylli i Dritës”, 1995, 3-4, f. 26-28.

⁵ A. Meksi – D. Komata, *Kisha e Shën Mërisë së Brrarit*, “Iliria”, nr. 2, 1987, f. 223.

⁶ A. Meksi – D. Komata, po aty; I. Zamputi, *Dy mbishkrimet...*, art, cit., HD, f. 23.

⁷ Shih P. Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, Pegi, Tiranë, 2006, f. 481.

siguruar ndihmën e Papës kundër Venedikut që po rrezikonte principatën⁸. Letra e Dhimitrit drejtuar Inocentit III duhet të ketë qenë hartuar në latinisht, nisur nga vetë përmbajtja dhe qëllimi i letrës. Ky dokument nuk është gjetur, por deduktohet nga përgjigjja e Papës drejtuar Dhimitrit. Letrën e Inocentit III po e japim të plotë, marrë nga “Patrologia Latina” e Jacques Paul Migne:

VII.

NOBILI VIRO DEMETRIO ARBANENSI PRINCIPI

Ei archidiaconus Durachii commendatur.

(Laterani, III Kal. Martii.)

Devotionem et reverentiam quam erga sacrosanctam Romanam Ecclesiam habere dignosceris in Domino commendantes, gratias referimus bonorum omnium largitori quod tibi et tuis inter Graecos minus catholice sentientes degentibus fidem reditam misericorditer inspiravit, ut recognoscens beato Petro a Domino esse dictum: *Tu es Petrus, et super hanc petram aedificabo Ecclesiam meam, et portae inferi non praevalerant adversus eam, et tibi dabo claves regni coelorum, et quodcunque ligaveris super terram, erit ligatum et in coelo (Matth. XVI)*, et iterum circa passionem ipsius: *Simon, ego pro te rogari ut non deficiat fides tua, et tu aliquando conversus confirma fratres tuos (Luc. XXII)*, rursusque post resurrectionem suam trino repetito vocabulo eidem dixisse: *Si diligis me, pasce oves meas (Joan. XXI)*, per litteras tuas quas benignitate paterna suscepimus, postulares ut a latere nostro legatum, qui te ac tuos erudiat in fidei puritate, mittere dignemur. Nos ergo proponimus ut ad partes illas legatum qui pascat, confirmet, et corrigat quae corrigenda invenerit, transmittamus, dilectum filium Nicolaum archidiaconum Latinorum Durachii, per nostras dantes litteras in mandatis ut ipse interim ad Arbanam accedat, et te ac tuos una cum venerabili fratre nostro Paulo Arbanensi episcopo instruat et confirmet in iis quae viderit expedire; ut cum legatus advenerit, vos ex parte inveniat eruditos. Monemus igitur nobilitatem tuam et exhortamur in Domino, per apostolica tibi scripta mandantes quatenus praedictum archidiaconum suscipiens honorifice ac honeste pertractans, ejus salubria monita et praecepta devote recipias et observes; ut ex hoc cumulus tibi aeternae retributionis accrescat, et nos devotionem tuam possimus merito commendare.

Datum Laterani, III Kal. Martii, anno undecimo.⁹

“Zotit fisnik Demetrit, Princ i Arbërit,
të cilit i rekomandoj Arqidhjakun e Durrësit.

Duke ia përcjellë Zotit fjalën tënde lidhur me përkushtimin dhe nderimin që ti ndjen ndaj Kishës shumë të shenjtë romane, i përcjellim

⁸ *Historia e Shqipërisë*, I, USHT, Tiranë, 1959, f. 196.

⁹ J. P. Migne, *Patrologia latina*, vol. 215, kol. 1334-1344.

mirënjohjen tonë atij, blatuesit të çdo gjëje të mirë. E pra, me të marrë vesh se mëshirëploti të tregoi ty dhe njerëzve të tu fenë e vërtetë, pasi deri atëherë, duke jetuar mes grekëve, ishit besimtarë të padenjë, sepse duhet ta dish se Zoti i tha Shën Pjetrit: *Ti je Pjetër, dhe mbi këtë gur do të ndërtoj kishën time dhe portat e Ferrit nuk do ta mposhtin atë, dhe unë do të të jap çelësat e mbretërisë së qiejve dhe çdo gjë që do të lidhësh në tokë do të jetë lidhur edhe në qiell (Matth. XVI)*, dhe, gjithashtu, lidhur me pasionin e këtij tha: *Simon, unë jam lutur për ty që besimi yt të mos mpaket, dhe ti, mbasi je konvertuar, përforco vëllezërit e tu (Luka XXII)*, dhe përsëri mbas ringjalljes, duke përsëritur tri herë të njëjtën fjalë, tha: *Nëse më do mua, kullot grigjën time (Gjoni XXI)*. Nëpërmjet letrës sate, që e morëm me dashamirësi atërore, ti kërkoje që ne të dërgonim një ambasador, i cili të të mësonte ty dhe njerëzit e tu në pastërtinë e fesë. Ne propozojmë që të dërgojmë në ato anë një legat që të ushqejë [grigjën], të përforcojë dhe të ndreqë ato që do të gjejë se duhen ndrequr, duke porositur ndërkohë birin tonë të dashur Nikollën, arqidhjakun e latinëve të Durrësit, me anë të letrave tona mandatore, që ai vetë ndërkohë të shkojë menjëherë në Arbanë, që bashkë me vëllain tonë të nderuar Palin peshkopin e Arbërit, të mësojë dhe të forcojë në ato që do të shohë se duhen bërë shpejt, në mënyrë që kur të vijë aty legati, të të gjejë ty dhe të tutë pjesërisht të mësuar. Prandaj e këshillojmë fisnikërinë tënde dhe e nxisim në emër të Zotit, duke të porositur nëpërmjet letrash apostolike, që arqidhjakun në fjalë ta presësh dhe ta trajtosh gjithmonë me nderim dhe ndershmëri, të dëgjosh këshillat dhe mësimet e tij të shëndosha me devotshmëri, që kështu të të rritet kredia e shpërblimit të përjetshëm, dhe ne të mund të rekomandojmë me meritë përkushtimin tënd.

Shkruar në Laterano, 28 shkurt 1208”*

Dokumenti i vetëm që na ka arritur nga veprimtaria e Principatës së Arbërit është Marrëveshja tregtare e Dhimitrit me republikën e Raguzës. Dokumenti është gjithashtu në latinisht dhe i përket vitit 1210¹⁰. Ai është hartuar në kushtet e nevojës së Principatës së Arbërit për lidhje miqësore dhe marrëveshje me fqinjët për të përballuar kërcënimin që vinte nga Venediku. Këto letra flasin për një veprimtari diplomatike të shtetit të parë shqiptar, që ka qenë më e gjerë se kaq, po të kemi parasysh edhe një marrëveshje të mundshme, që duhet të ketë bërë kreu i tij për forcimin e lidhjeve me Despotatin e Epirit¹¹.

* Përkthimi në shqip nga Pëllumb Xhufi.

¹⁰ P. Xhufi, *Jeta politike në Shqipëri*, në: S. Anamali et. al., “Historia e popullit shqiptar”, I, f. 231.

¹¹ Khs. *Historia e Shqipërisë*, I, 1959, f. 197.


Fatkeqësisht dokumentacioni, sado i paktë, i Principatës së Arbërit nuk u ka mbijetuar rrebesheve të kohës, ashtu si dhe shumica e shkrimeve në Shqipëri, të cilat i ka ndjekur ndeshtrasha e keqe e djegieve, mbytjeve në lumë, humbjeve në mënyra nga më të ndryshmet (kujto gramatikën e Ndre Bogdanit që “ntreti si krypa nd’ujët”, barrën me dorëshkrime të Pjetër Budit që u mbyt bashkë me të në lumin Drin apo dy arkat me dorëshkrime të Gjon Kazazit që u dogjën pas vdekjes nga padija e atyre që la pas¹² e dëshmi të tjera për djegie kishash e librash¹³) njësoj si autorët apo ruajtësit e tyre të përndjekur nga pushtuesit.

Prandaj është fat që është ruajtur akti tregtar i Dhimitrit të Arbërit me qytetin e Raguzës, i cili është i gjetur si faksimile e origjinalit nga P. Xhufi. Më parë ky dokument njihet në transkriptimin e A. Solovjevit¹⁴ dhe ishte botuar i përkthyer në shqip në tekstin e Historisë së Shqipërisë, 1959. Këtu po japim faksimilen e dokumentit origjinal të vitit 1210, i shkruar me dorë, me shkronja të tipit gotik, shumë i përhapur në Evropën e shek. XIII, me siguri në pergamenë, meqë letra si material i ri shkrimi fillon që nga mesi i shek. XIII. Mënyra e shkrimit është e tipit noterial, me shkurtime të shumta. Siç shihet, edhe ky dokument mezi u ka shpëtuar flakëve, duke pësuar dëmtime të pjesshme.

¹² Shih. B. Demiraj, *Jeta dhe trashëgimia e Gjon P. Nikollë Kazazit*, Botime Françeskane, Shkodër, 2013, f. 104.

¹³ Khs. Dh. Shuteriqi, *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, ASHSH IGJL, Tiranë, 2005, f. 119.

¹⁴ A. Soloviev, *Eine Urkunde des Panhypersebastos Demetrios megas archon von Albanien*, “Byzantinische Zeitschrift”, 1934.



Faksimile e marrëveshjes tregtare të Dhimitrit të Arbërit me Raguzën.

Ego Demetrius, Dei gratia, panhypersebastos et magnos archon, juro super quattuor sancta dei evangelia, sine fraude et malo ingenio, firmam pacem habere et manutenere semper vite mee dum vixero civitati Ragusii et omnibus hominibus raguseis ut ipsi ragusei salvi et securi ambulent per totam teram meam sine ullo datio in omnibus iustitiis suis tam per terram quam per mare liberi et securi et sicut ego hoc iuro et firmo ita precipio omnibus hominibus meis ut hoc iurent et firmiter teneant omnibus diebus vite eorum.

Ego Andreas Stapanus iuravi. Ego Ionima iuravi. Ego Marteni iuravi. Ego Alexi iuravi. Ego Paullus iuravi. Ego Demetrius iuravi. Ego Cosmas iuravi. Ego Ferneti iuravi. Ego Lazarus iuravi. Ego Johanes iuravi. Ego Nicolaus iuravi. Ego Postus (?) iuravi. Ego... iuravi. Ego Leti iuravi. Ego Sundia Andrea iuravi.

Përktimi shqip:

“Unë Dhimitri, për hir të Zotit panhipersebast dhe arkond i madh, betohem mbi katër ungjijtë e shenjtë të Zotit, se pa mashtrim e dijekeqi, do të bëj paqe të qëndrueshme e do ta ruaj atë gjatë gjithë jetës sime sa të jem gjallë me qytetin e Raguzës dhe të gjithë raguzanët, në mënyrë që këta raguzanë të lëvizin të paprekur e të sigurt në të gjithë tokën time pa asnjë taksë doganore në të gjitha të drejtat e tyre si në tokë ashtu dhe në det të lirë e të sigurt, dhe siç betohem dhe e përforcoj unë këtë, ashtu urdhëroj të gjithë njerëzit e mi që

të betohen për këtë dhe ta respektojnë fort gjatë gjithë ditëve të jetës së tyre.”¹⁵

Edhe në këtë dokument vihet re ndikimi i traditës bizantine në titujt bizantinë të Dhimitrit, “panhipersebast” dhe “arkond i madh”. Përveç kësaj aty na dalin edhe emrat e titujt jobizantinë të disa krerëve në varësi të Dhimitrit, ndër të cilët vëmë re ndikime sllave, që ndërthuren me ato bizantine. Stapani duhet të jetë emër profesioni i personit të quajtur Andrea, pra “djathar, baxhoxhi”, nga sllav. *stopan* “zot shtëpie, pronar”, që ka mbetur si mbiemër familjeje Shtëpani në Shëngjergj të Tiranës¹⁶. Një emër tjetër profesioni ose titull del te një tjetër Andrea i mbiquajtur Sundia, sllavisht “gjykatës”, edhe ky një emër sllav, i cili nuk ka mbijetuar në gjuhën shqipe, përveç se në derivatin *sundoj*¹⁷. *Sundia* pas gjase është ekuivalent me greq. *archon* dhe lat. *iudex*, kjo e fundit një interpretim latin i emërtimit grek¹⁸, me të cilin është quajtur Dhimitri në një letër tjetër të papës Inocent¹⁹. Edhe vetë emri i Dhimitrit, që në mbishkrimin e Gziqit paraqitet si Dimitri, është një ndikim sllav, ashtu si dhe, me gjasë, emri i paraardhësit të tij Progonit, një emër gjithsesi tipik për shqiptarët, siç e ka vënë në dukje Jirečeku²⁰.

Latinisht është edhe mbishkrimi tjetër i rëndësishëm i Gziqit në Mirditë, në të cilin dalin emrat e sundimtarëve të Arbërit, Dhimitrit e Progonit. Mbishkrimi është i padatuar, por meqë bën fjalë për zbatimin e testamentit të Dhimitrit për ndërtimin e një kisha, duhet të jetë pas vitit 1216 të vdekjes së tij. Më poshtë është faksimile e mbishkrimit në riprodhim besnik nga Injac Zamputi, i cili ka bërë edhe leximin më të plotë të tij²¹.

¹⁵ Një përkthim i ngjashëm gjendet edhe në *Historia e Shqipërisë*, I, USHT, Tiranë, 1959, f. 197.

¹⁶ Xh. Ylli, *Das slavische Lehngut im Albanischen*, München, 1997, f. 248.


¹⁷ A. Omari, *Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe*, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2012, f. 290.

¹⁸ L. Thalloczy, C. Jireček, E. Sufflay, *Acta Albaniae*, Vindobonae, 1913, f. 43, dok. 135.

¹⁹ *Acta Albaniae*, po aty.

²⁰ C. Jireček, *Byzantinische Zeitschrift*, 13. Band (1904), f. 197, shih P. Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, vep. cit., f. 84.

²¹ I. Zamputi, *Rindërtimi i mbishkrimit të Arbërit dhe mundësitë e reja për leximin e tij*, “Iliria”, viti 1984, nr. 2, f. 207-218.



Me gjithë mbizotërimin e kulturës dhe gjuhës latine, ndikimi kulturor bizantin në trevën e Arbërit ka qenë i pandërprerë deri në prag të pushtimit turk (1415-1417). Mbas vdekjes së Dhimitrit, Principata e Arbërit ra përsëri nën vasalitetin e Despotatit të Epirit e pastaj nën Perandorinë Bizantine të Nikesë. Pasardhësi i Dhimitrit në sundimin e Arbërit, Grigor Kamona, në letërkëmbimin e tij me kryepeshkopin e Ohrit Dhimitër Komatianin përdor gjuhën greke dhe në të njëjtën gjuhë janë shkruar edhe përgjigjet e këtij të fundit.

Dëshmi të tjera për përdorimin e greqishtes, jo vetëm në dokumentet e Vlorës, Beratit dhe Ohrit, por edhe në Shqipëri të Mesme sjellin M. Šufflay dhe C. Jireček, si p.sh. paktet në gjuhën greke që bënë anzhuinët me Muzakajt (1336), pakti i Niketë Topias me Venedikun në greqisht (1408) etj.²² Durrësi ishte qyteti ku kishte notariat latin krahas atij grek dhe ku ndeshen dokumente latine krahas atyre greke, ose edhe bilingue, deri në kohën veneciane²³. Më tej O. Schmitt përmend dëshmi që e shtrijnë përdorimin e greqishtes më në veri,

²² M. Shuflaj, *Qytetet dhe kështjellat e Shqipërisë kryesisht në Mesjetë*, Onufri, Tiranë, 2009, f. 157 v.; C. Jireček, *Byzantinische Zeitschrift*, 13. Band (1904), f. 200 v.

²³ M. Shuflaj, *Po aty*, f. 156-157.

si p.sh. përdorimi i greqishtes si gjuhë e folur në oborrin e zotit të Krujës, Kostandin Balshës (AAV II 574), letër në gjuhën greke e Gjon Kastriotit më 1428 drejtuar Senatit të Venedikut, një marrëveshje e peshkopit të Krujës me mbretin e Napolit shkruar në latinisht me shkronja greke (“in litteris graecis”) (Radonić Nr. 38)²⁴.

Megjithatë, ndikimi grek nuk u shty përtej Krujës. Në vitin 1197 peshkopata e Krujës duket se kaloi në duar katolike²⁵. Një dëshmi që flet për zhdukjen e gjuhës greke nga veriu i Shqipërisë, është ajo e Mihail Apostolit nga Kostandinopoja, i cili vizitoi Shkodrën më 1467 dhe vuri re “që në gjithë këtë trevë askush nuk e kupton më gjuhën e shenjtë”²⁶.

Që nga gjysma e dytë e shek. XII në veriun e Shqipërisë, nga Durrësi deri në Raguzë, fillon të depërtojë edhe shkrimi në gjuhën sllave, i cili vjen që nga ishulli Veglia i Dalmacisë gjatë bregdetit deri në Ulqin. Më pas, me pushtimet serbe në shek. XIV shkrimet në gjuhën sllave erdhën duke u përhapur nga veriu në jug deri në rrethin e Durrësit, madje deri në Vlorë²⁷, duke konkurruar fort latinishten si gjuhë e dokumentacionit zyrtar. Autorët e Acta Albaniaie njoftojnë se në fillim të shek. XV kancelarët e princave shqiptarë shkruanin serbisht dhe sjellin si dëshmi një letër të raguzanëve për mbretin hungarez Sigismund, sipas të cilës në vitin 1434 Andrea Topia kishte vetëm “kancelarë sllavë që dinin gjuhën dhe shkrimin sllav”; për letrat latinisht ai duhej t’u drejtohej “kancelarëve latinë” të bregdetit²⁸. Në Shqipërinë Qendrore në fund të shekullit XIV takoheshin të tri zonat e gjuhëve të dokumenteve mesjetare, zona e latinishtes, e greqishtes dhe e sllavishtes. Këtë e dëshmon mbishkrimi tregjuhësh i Karl Topisë në manastirin e Shën Gjon Vladimirit në Elbasan, i vitit 1381.

Ç’mund të themi për gjuhën shqipe në këtë periudhë paraletare të saj? Ndërsa gjuhë letrare e zyrtare e shteteve dhe principatave që përfshinin territoret arbërore, ishin dy gjuhët ndërkombëtare të kohës, madje edhe sllavishtja si një gjuhë e stabilizuar letrare dhe kishtarë që nga shekulli IX, popullsia në shumicë shqiptare e këtyre trevave fliste gjuhën shqipe. Është një

²⁴ Khs. O. Schmitt, *Arbëria Venedike*, K&B, 2007, f. 89.

²⁵ A. Ducellier, *Albania, Serbia and Bulgaria*, në: “The New Cambridge Medieval History”: Volume 5, C: 1198-c. 1300, ed. by D. Abulafia, Cambridge University Press, 1999, f. 786, shën. 39. (Duc. 1987d, f. 3-4; Cirković, 1988, f. 348-9.)

²⁶ G. Schirò, *Visita a Scutari di Michele Apostolio nel 1467*, “Zeitschrift für Balkanologie”, 2 (1964), f. 150; O. Schmitt, *Arbëria Venedike*, vep. cit., f. 89.

²⁷ M. Shuflaj, *Qytetet dhe kështjellat*, vep. cit., f. 156.

²⁸ C. Jireček, M. Šufflay, *Illyrisch-albanische Forschungen*, zusammengestellt von dr. Ludwig von Thallöczy. I Band, Verlag von Düncker & Humblot, München und Leipzig, 1916, f. 81; M. Shuflaj, *Qytetet dhe kështjellat*, vep. cit., f. 157.

fakt i njohur, edhe për kohën e sotme, që gjuha zyrtare dhe e kulturës e një vendi mund të jetë një gjuhë e huaj, e ndryshme nga gjuha e folur e popullsisë, që e përdorin dhe nuk përcakton etnicitetin e këtyre. Për ekzistencën e gjuhës shqipe kemi dëshmi të drejtpërdrejta, që fillojnë nga shekulli XIII, por edhe të dhëna të tërthorta. Dëshminë më të hershme për ekzistencën e gjuhës shqipe e kemi jashtë kufijve të Shqipërisë, në Raguzë, ku në shekullin XIII duhet të ketë pasur një bashkësi shqiptare. Në vitin 1284, gjatë hetimit të një rasti grabitjeje atje, është regjistruar kjo fjali e një dëshmitari të ngjarjes: *Audivi unam vocem clamantem in monte in lingua Albanesca*. Jo shumë kohë mbas kësaj dëshmie, kemi njoftimin e *Anonymi descriptio Europae Orientalis* (1308) që tregon se gjuha shqipe nuk ka lidhje afërie me asnjërën prej gjuhëve fqinjë: “*habent enim Albani prefati linguam distinctam a Latinis, Grecis et Sclavis ita quod in nullo se inteligunt cum aliis nationibus*”²⁹. E fillimit të shek. XIV është edhe dëshmia e arqipeshkvit francez të Tivarit, Guljelmit të Adës ose murgut Brocardus, i cili në vitin 1332 shkruan: *Licet albanenses alliam omnino lingua a latinam habent et diversam, tamen litteram latinam habent in usu et in omnis suis libris*.

Dhimitër Shuteriqi në veprën e tij të çmuar *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800* ka mbledhur me durim e përkushtim çdo të dhënë të drejtpërdrejtë e të tërthortë për shqipen e folur ose të shkruar para periudhës letrare të saj. Ndër këto të dhëna të tërthorta janë edhe dëshmitë për ekzistencën e “këngëve luftarake dhe të fitoreve” që thur populli për ngjarjet e rëndësishme të kohës, siç është ajo e Teofilaktit, kryepeshkopit të Ohrit (rreth 1111), apo dëshmitë e historianëve Antonio Sabellico e Marin Barleti për këngët epike për Skënderbeun³⁰. Vetë eposi legjendar shqiptar me zanafillën e tij të hershme mesjetare është një dëshmi për ekzistencën e një tradite gojore për përshkrimin e ngjarjeve historike në formë këngësh, në kushtet e mungesës së shkrimit në popull.

Një të dhënë të tërthortë për gjuhën e vendit në Arbër mund ta marrim edhe nga letra e Inocentit III si përgjigje e kërkesës së Dhimitrit për ndihmë. Papa propozon të dërgojë në Arbër fillimisht arqidhjakun e latinëve të Durrësit, Nikollën, i cili, bashkë me peshkopin e Arbërit, Palin, të mësonte shpejt gjërat kryesore të fesë para se të vijë i dërguari që do të zhvillojë mësimet e fesë në popull, ose edhe vetëm ndër krerët e Arbërit. Në ç’ gjuhë do të predikonte Nikolla në Arbër? Për shkak të nevojës së kishës që populli të kuptonte çfarë thuhej, Koncili i Turit i vitit 813 u dha legjitimitet gjuhëve popullore (vulgare) për sa i përket predikimit, ndërsa omelia (paraqitja dhe

²⁹ *Anonymi Descriptio Europae Orientalis*, ed. O. Gorka, Cracoviae, 1916, f. 29.

³⁰ Dh. Shuteriqi, *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, ASHSH, IGJL, Tiranë, 2005, f. 34.

komenti i ungjijve) mbetej në gjuhën latine³¹. Atë Justin Rrota, duke arsyetuar fragmentin e Perikopesë së ungjillit të Pashkëve në shqip, ndoshta të shek. XVI, përmend zakonin shumë të vjetër, “*ab immemorabili*”, sipas të cilit, mbas leximit në gjuhë liturgjike, këndohej edhe në gjuhë të popullit Ungjilli i së dielës, zakon që më pas mbeti vetëm për leximin e ungjillit të Pashkëve³². Edhe Shuteriqi mendon se në kushtet e përplasjeve fetare midis kishave të Perëndimit e të Lindjes në Shqipëri, me ndarjen e kishave mbas shek. XI (1054), ishte e nevojshme që propagandistët fetarë t’i drejtoheshin popullit në gjuhën e vet³³. Në këtë hulli gjykimi mund të mendohet që arqidhaku Nikollë dhe peshkopi Pal të kenë mbajtur predikimet paraprake në gjuhën e vendit, ndërsa mësimet e legatit të Papës mund të jenë transmetuar me përkthim. Kjo duket e nevojshme po të kemi parasysh të dhënat për shkollimin e krerëve laikë në Shqipëri. Sipas dëshmimeve që jep I. Zamputi, në shek. XVII “në gjithë Shqipërinë a janë a s’janë dhjetë të krishterë shekullarë që dinë të lexojnë...”, dhe se krerët pjesëmarrës të kuvendeve të shekujve XVI-XVII nuk dinin as të shkruanin emrin e vet, prandaj kërkesat që dilnin nga këto kuvende nënshkruheshin nga klerikët e lartë në emër të pjesëmarrësve³⁴.

Për sa i përket shkrimit të gjuhës shqipe, duhet të krijoheshin kushtet e përshtatshme kulturore e politiko-kishtare për nismat individuale si ajo e Gjon Buzukut që shënoi fillimin e traditës letrare në gjuhën shqipe që nga shekulli XVI. Ky është shekulli i periudhës kulmore të Rilindjes evropiane (Renaissance) dhe njëkohësisht i lëvizjes politiko-fetare të Reformacionit që shënoi fillimin e përkthimeve biblike në gjuhët popullore. Brenda vendit ishin rrethanat e pushtimit osman me rrezikun e përhapjes së fesë së tij, që rizgjuan elementet e vetëdijes kombëtare dhe nxitën nevojën e ruajtjes së krishtëritimit nëpërmjet propagandimit të fesë në gjuhën e vendit.

Çështja e ruajtjes së fesë ishte e lidhur ngushtë me atë të trojeve të të parëve, që për atë fazë parakombëtare të formimit të kombit shqiptar ishin një koncept i pandarë³⁵. Bjerrja e fesë, dhe, bashkë me të, edhe e lirisë, shihej nga

³¹ Shih http://it.wikipedia.org/wiki/Concilio_di_Tours_%28813%29;
http://www.scuola.com/storiadiotti/PDF/04_AltoMedioevo/mondo_barbari/volgare.pdf

³² J. Rrota, *Per rreth botimit të dorëshkrimit shqyp të shekullit XIV*, “Hylli i Dritës”, nr. 7-8, 1930, f. 405.

³³ Dh. Shuteriqi, *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes*, vep. cit., f. 42.

³⁴ “affermo le cose suddette esser vere, et pregato da tutti ho sottoscritto per non saper loro scriver...”, shih I. Zamputi, *Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe*, “Hylli i Dritës”, nr. 1-2, 1995, f. 37, me citim të burimit përkatës.

³⁵ Khs. për konceptin “fe e atdhe” në shekujt e parë të pushtimit osman E. Çabej, *Pesëqindvjetori i shkrimit shqip. Kuvendi kishtar i Matit i vitit 1462 dhe Formula e Pagëzimit*, në “Studime Gjuhësore” VI, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 342.

elita e arsimuar e asaj kohe si një pasojë e padijes, një plagë e përhershme e shoqërisë shqiptare, dhe prandaj përpjekjet e tyre u përqendruan në përhapjen e dijes në gjuhën e vendit³⁶. Përpjekjet e autorëve të qarkut kulturor katolik verior të shekujve XVI-XVIII për lëvrimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe janë faktorë që ndikuan në ngjizjen e vetëdijes kombëtare të shqiptarëve në periudhën para Rilindjes kombëtare. Këtu i gjejmë edhe premisat e idesë së mëvonshme të një gjuhe të përbashkët letrare shqipe, e lidhur ngushtë me ngritjen e vetëdijes kombëtare. Autorët e vjetër shkruan në një gjuhë që nga një anë i kapërcente kufijtë nëndialektorë të të folmeve të tyre të veçanta, dhe kjo u bë edhe me vetëdije, siç na kumton shprehimisht njëri prej tyre, Pjetër Bogdani, për t'u pranuar nga publiku "letrar" i kohës, por nga ana tjetër edhe në një bazë dialektore që asokohe përfshinte një hapësirë të gjerë nga verilindja në veriperëndim, pra ishte një lloj koineje veriore e përzier me trajta dialektore, siç e përcaktoi Çabej gjuhën e 'Mesharit'³⁷ dhe që Desnickaja e zhvilloi më tej me idenë e "koinesë gojore mbidialektore të Veriut", e cila përmbante edhe trajta konservative të afërta me toskërishten³⁸. Veprat e autorëve të vjetër nuk patën përhapje të kufizuar vetëm në arealin verior të hapësirës shqiptare. Ato me shumë gjasë u njohën edhe në jug të vendit, të paktën për sa dimë nga dëshmitë për Doktrinën e Budit. Kur misionari bazilian Neofit Rodinoi në vitin 1637 i kërkoi Propagandës Fide të botojë një Doktrinë të krishterë, që po përkthehej në shqip nga prifti Dhimitër për shkollën e Dhërmiut, ai mori përgjigjen se Doktrina ishte botuar shqip dhe mund t'i dërgonte disa kopje nëse dëshironte. Në këtë rast bëhej fjalë për Doktrinën e Budit, që sapo ishte ribotuar nga Propaganda në vitin 1636³⁹.

Në periudhën e konsolidimit të sundimit osman pas dështimit të Aleancës së krishterë në luftën me Perandorinë osmane (1683-1699) tradita gjuhësore-letrare e shkrimeve fetare në Veriun katolik të Shqipërisë bie fashë gjatë shekullit XVIII⁴⁰.

³⁶ Vetëm dy shekuj më vonë, në periudhën e Rilindjes kombëtare, do të shprehej në mënyrë eksplicite ideja e lidhjes së ngushtë midis atdhetarizmit, dijes dhe fesë. Kështu kleriku patriot Said Najdeni (Hoxhë Voka) shprehej: "Me dituni ruhet mëmëdheu, me dashuni të mëmëdheut shtrëngohet feja". Khs. Natalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, Botime "Përpjekja", Tiranë, 2009, f. 424.

³⁷ E. Çabej, "Meshari" i Gjon Buzukut (1555), botim kritik, Tiranë, 1968, "Hyrije" f. 19-22, 64 v..

³⁸ A. V. Desnickaja, "Çështja e Koinesë së Veriut në kuadrin e përgjithshëm të historisë së gjuhës shqipe", *Studime*, nr. 1, ASHAK, 1994, f. 141-156.

³⁹ Khs. Dh. Shuteriqi, *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, ASHSH, IGJL, Tiranë, 2005, f. 185-186.

⁴⁰ Khs. psh. P. Jak Junggu: "...nella quasi mancanza di letteratura, in cui per la nequizia dei tempi, restò fin dopo la metà del nostro secolo la lingua albanese,

Në gjysmën e dytë të shek. XVIII, në një fazë zhvillimi ekonomik dhe qetësimi të trazirave antiosmane, që u shoqërua edhe me përhapjen masive të islamizmit në trojet shqiptare, vetëdija kombëtare, në dukje e fjetur e etnosit shqiptar, gjen shprehje në traditën letrare shqipe të qarkut kulturor ortodoks të Shqipërisë së Mesme me qendër në Elbasan. Në këtë areal u zhvillua edhe kisha ortodokse nën juridiksionin e Patrikanës me qendër në Ohër deri në vitin 1769, kur u zhvendos në Stamboll. Disa nga klerikët më të shquar të kësaj kishe ishin formuar në Akademinë e famshme të Voskopojës, që frymëzohej nga iluminizmi evropian dhe ndikoi në formimin e identitetit kombëtar të popujve të Ballkanit. Për dy nga emrat më të njohur të dalë nga kjo shkollë, Grigori i Durrësit dhe Teodor Haxhifilipi, ka dëshmi se kanë luajtur një rol të dorës së parë në lëvrimin e letërsisë biblike në gjuhën shqipe. Sipas autorit grek të shek. XVIII, Jorgo Zavira, Grigori përktheu Dhiatën e vjetër dhe Dhiatën e re, me shkronja shqipe që i shpiku vetë, të paktën më se gjysmë shekulli para përkthimit të Dhiatës së Re nga Vangjel Meksi e Grigor Gjirokastriti. Dhaskal Todhri po ashtu, siç dëshmon Hahni, thuhet se ka përkthyer të dy Dhiatat, me një alfabet të posaçëm, të shpikur ose të sjellë prej tij në Elbasan. Për fat të keq dorëshkrimet e këtyre përkthimeve kanë humbur pa gjurmë ose janë shkatërruar, siç njofton Hahni për shkrimet e Todhrit. Megjithatë janë ruajtur disa fragmente nga shkrimet e Todhrit dhe sidomos një dorëshkrim anonim elbasanas, ndoshta nga një Teodor Bogomili, sipas Shuteriqit. Ajo që ka rëndësi të theksohet për traditën letrare elbasanase, është pohimi i Hahnit se Dhaskal Todhri u mor me krijimin e një gjuhe letrare të përbashkët për të dy dialektet e shqipes, aq të ndryshëm nga njëri-tjetri⁴¹. Sipas këtij pohimi do të kishim përpjekjen më të hershme për një gjuhë të përbashkët letrare shqipe, që do t'i paraprinte me një shekull ideve të Rilindjes kombëtare. Rajko Nachtigall e ka shtyrë më tej kontributin atdhetar të Teodor Haxhifilipit duke hedhur idenë se ai ka dashur të krijojë një kishë kombëtare shqiptare, ideja e së cilës jetonte ende në Elbasan deri në kohën kur ai e vizitoi qytetin (1917)⁴². Në këtë mënyrë ai vendos një paralelizëm mes veprimtarisë së Todhrit dhe asaj të Dositej Obradovićit për sllavët e jugut dhe Adamant Koraisit për grekët, të cilët, nën ndikimin e iluminizmit perëndimor të shkollave më progresiste të Gadishullit dhe në një kontekst kulturor-historik të përbashkët ballkanik, përdorën gjuhën popullore në letërsi

andarono in disuso ed in dimenticanza, né or più si capiscono dal volgo, molti termini di buona lingua...”, në: *Fialuer i voghel sccßpp e llinisct*, Shkodër, 1895, f. 179; G. Petrotta, *Popolo, lingua e letteratura albanese*, Albanica 18/1, a cura di Matteo Mandalà, AC. Mirror, Palermo, 2003, f. 121.

⁴¹ J. Georg von Hahn, *Albanesische Studien*, I, Jena, 1854, f. 296.

⁴² R. Nachtigall, *Die Frage einer einheitlichen albanischen Schriftsprache*, Graz, 1917, f. 15.

duke u bërë themeluesit e gjuhëve letrare të popujve të tyre me bazë gjuhën e folur⁴³. Nga fragmentet e shkrimeve të Todhrit të gjetura në manastirin e Shingjonit pranë Elbasanit dhe të botuara nga studiues të ndryshëm, si Hahni, Geitleri, Pekmezi, Nachtigalli, Lef Nosi, Dh. Shuteriqi, mund të gjykojmë për dialektin e përdorur nga Todhri, i cili, sipas Hahnit, duket shumë i purifikuar dhe i afruar me toskërishten, në dallim nga disa poezi gegërisht që gjendeshin në një fletore tjetër⁴⁴. Analiza e gjuhës së Todhrit nxjerr në pah bazën dialektore gego-jugore të Elbasanit, me lidhje të shumta me toskërishten⁴⁵. Por këto përkime me toskërishten duken të jenë karakteristika të një faze më të vjetër të gegërishtes jugore të Elbasanit sesa një përzjerje e vetëdijshme me qëllim krijimin e një gjuhe të përbashkët. Tipare të ngjashme me karakteristika të të dy dialekteve shfaq edhe gjuha e Dorëshkrimit anonim të Elbasanit, e cila paraqet veçori më arkaike se gjuha e Todhrit, që nga një anë përkohet me veçoritë gjuhësore të teksteve të vjetra të Veriut, dhe nga ana tjetër me tiparet e toskërishtes së vjetër⁴⁶.

Pavarësisht nëse kjo përzjerje gjuhësore është bërë me vetëdije ose jo, atë e ka lehtësuar fakti që e folmja e Elbasanit, në fazat më të vjetra, ishte shumë më pranë toskërishtes nga ç'është sot.

Nga ana tjetër kanë luajtur rol edhe bashkëveprimet ndërdialektore në zonën ekonomiko-tregtare dhe kulturore, që në shekullin XVIII përfshinte një hapësirë të pandërprerë nga Durrësi e Elbasani në veri e deri në Follorinë e Janinë në jug⁴⁷. Me këto ndikime ndërkrahinore dhe me traditën shkrimore me bazë gegërishten e Elbasanit shpjegohen edhe gegizmat në tekstet shqip të Kavaliotit e të Danil Voskopojarit apo të Nektar Terpos⁴⁸. Një lidhje e autorit të Anonimit të Elbasanit me Voskopojën na dëshmohet nga një përkim interesant leksikor që vihet re në tekstin e Anonimit dhe në fjalorin e Teodor

⁴³ R. Nahtigal, *O elbasanskem pismu i pismenstvu na njem*, Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju, I, Beograd, 1924, f. 180-181.

⁴⁴ J. G. von Hahn, *Albanesische Studien*, vep. cit., f. 298, shën. 1.

⁴⁵ Shih më hollësisht për gjuhën e Todhrit Dh. Shuteriqi, *Dhaskal Todhri*, "Buletin i Institutit të Shkencave", nr. 4, 1954; A. Omari, *Fillesat e idesë për një gjuhë të përbashkët letrare shqipe*, në: "Një rilindje para Rilindjes", Konferencë shkencore ndërkombëtare albanologjike, Universiteti "Eqrem Çabej" i Gjirokastrës, Gjirokastrë, 2014, f. 250-252.

⁴⁶ Shih më hollësisht për gjuhën e Anonimit A. Omari, *Fillesat e idesë për një gjuhë të përbashkët letrare shqipe*, art. i cit., f. 252-255.

⁴⁷ Xh. Lloshi, *W. Martin-Leake për shqiptarët dhe gjuhën shqipe*, studim hyrës në: W. Martin-Leake, *Kërkime për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe*, përkthyer dhe paraqitur nga Prof. Xhevat Lloshi, Bota Shqiptare, 2006, f. 68 v.

⁴⁸ Shih Xh. Lloshi, *W. Martin-Leake për shqiptarët dhe gjuhën shqipe*, studim hyrës në: W. Martin-Leake, *Kërkime për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe*, vep. cit. f. 67-71 e vijim.

Kavaliotit⁴⁹: është fjala për neologjizmin *kullotës* “bari”, që s’e kemi hasur gjekundi tjetër.

Përpjekjet për shkrimin e shqipes me alfabete të posaçme në shek. XVIII dhe për kthimin e shkrimeve fetare në shqip, me synimin për t’u shkëputur nga ndikimet e huaja dhe për të afirmuar liturgjinë fetare në gjuhën kombëtare, natyrisht duhen konsideruar shfaqje të vetëdijes kombëtare shqiptare mjaft kohë përpara Rilindjes⁵⁰. Në këtë mes nuk është pa domethënie fakti se alfabeti origjinal për shqipen që shpiku Todhri shërbeu në shek. XIX në Elbasan si shenjë e shqiptarizmit të atyre që e përdornin, në dallim nga përkrahësit e kishës greke që përdornin shkronjat greke, dhe si një kërkesë për të afirmuar më mirë gjuhën shqipe si një gjuhë e veçantë dhe popullin shqiptar si i dalluar nga të tjerët⁵¹.

U ndalëm pak më gjatë në traditën shkrimore të shek. XVIII për të theksuar faktin se ky shekull nuk ishte shekulli i përgjumjes kombëtare, por paraprijësi dhe ndriçuesi i rrugës drejt Rilindjes Kombëtare të shekullit XIX. Gjithsesi vetëm në këtë shekull u zhvilluan dhe u poqën në mënyrën më të plotë kushtet ekonomike-shoqërore, historike, politike e kulturore që bënë të mundur ngjizjen e ideologjisë kombformuese shqiptare, që vendoste në plan të parë vlerat kombëtare mbi partikularizmat krahinore e fetare. Për arsye të zhvillimit më të madh ekonomik e kulturor të vendit ku kishin gjetur strehë prej qindra vjetësh, këto kushte u poqën më herët tek arbëreshët e Italisë, prej të cilëve dolën edhe disa nga nismëtarët e Rilindjes kombëtare shqiptare. Krahas me traktatet për identitetin historik-kulturor, antropologjik e gjuhësor të arbëreshëve si popull i ndryshëm nga grekët, me të cilët shpesh herë i ngatërronin për shkak të përkatësisë së njëjtë fetare, ndër dijetarët arbëreshë u artikulua më herët edhe ideja e një gjuhe të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Kjo ide u shpreh së pari në mënyrë të vetëdijshme dhe të argumentuar nga gjuhëtari i shquar Dhimitër Kamarda në vitet 1864-1866, kur shtroi nevojën për një gjuhë të përbashkët për të gjithë kombin shqiptar, me perspektivën për t’u bërë ajo një ditë edhe gjuhë letrare⁵². Po kështu De Rada më herët kishte hedhur idenë e një gjuhe letrare për të gjithë arbëreshët dhe shqiptarët⁵³, edhe

⁴⁹ Shih për fjalorin e Kavaliotit Dh. Shuteriqi, *Tekstet shqipe*, vep. cit., f. 303.

⁵⁰ Khs. edhe R. Elsie, *Dorëshkrimi elbasanas i Ungjijve, 1761, dhe lufta për krijimin e një alfabeti shqiptar*, “Studime”, nr. 1, ASHAK, Prishtinë, 1994, f. 134.

⁵¹ Dh. Shuteriqi, *Anonimi i Elbasanit*, art. i cit., f. 47.

⁵² D. Camarda, *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Livorno, 1864, f. 8; Po ai, *Appendice al saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Prato, 1866, Discorso preliminare, f. IV.

⁵³ Në vitin 1847 V. Dorsa shkruante: “Il signor Girolamo De Rada fin dai primi suoi anni si ha fissato in mente di creare una letteratura albanese, e fermo su questo pensiero, per riuscirci, si avvertiva dover muovere i passi dai canti popolari, comeché

pse e shihte këtë gjuhë të e folmja e shkruar e arbërishtes së Kalabrisë, pra te gjuha që përdorte ai vetë⁵⁴. Jo shumë vite më vonë, në 1877, një kërkesë të ngjashme do ta shtrojë mendimtari dhe atdhetari i spikatur pararendës i Rilindjes, Zef Jubani, kur kërkon së pari një alfabet të përbashkët për të gjithë shqiptarët, në mënyrë që gjuha shqipe të ketë letërsinë e vet me parime të përshtatshme për natyrën e saj⁵⁵, dhe pastaj, edhe një gjuhë letrare të përbashkët. Këtë gjuhë ai e mendon si zgjedhje të filologëve në bazë të krahasimit të dialekteve të ndryshme të shqipes dhe vlerësimit të njërës prej tyre si më i përshtatshmi⁵⁶. Më pas është Rilindasi i madh, Sami Frashëri, që do të vërë theksin te shkrimi i gjuhës, si detyra parësore që duhet të kryejë një komb për të ruajtur kombësinë e tij⁵⁷, ndërsa për të ardhmen parashikon një

di la cominci la letteratura di ciascun popolo. S'ingegnò quindi ben per tempo a studiare l'indole e l'andamento della sua lingua, onde menarla ad un certo passo di sviluppo. È questo il motivo per cui questo giovine detta continuamente e con nobile costanza in albanese le sue poesie. L'idea poi dominante nei suoi canti, e nella quale come in un foco vanno a congiungersi tutte le altre, si è quella della liberazione della patria", khs. V. Dorsa, *Su gli albanesi: ricerche e pensieri*, Napoli, 1847, f. 132-133; G. Petrotta, *Popolo, lingua e letteratura albanese*, vep. cit., f. 235. ["Zoti G. De Rada që nga fillimet e tij ka ngulitur në mendje të krijojë një letërsi shqipe, dhe i vendosur në këtë mendim, për t'ia dalë mbanë, përpiquej të nisej nga këngët popullore, meqenëse atje fillon letërsia e çdo populli. Prandaj me kohë u përpoq të studiojë natyrën dhe ecurinë e gjuhës së tij, për ta çuar në një shkallë të caktuar zhvillimi. Kjo është arsyeja për të cilën ky djalosh dikton vazhdimisht dhe me këmbëngulje fisnike në shqip poezitë e tij. Kurse ideja mbizotëruese e këngëve të tij, dhe në të cilën bashkohen si në një zjarr të gjitha të tjerat, është ajo e çlirimit të atdheut"].

⁵⁴ Khs. J. Kastrati, studim hyrës në: Zef Jubani, *Vepra të zgjedhuna*, Tiranë, 1966, vep. cit., f. 40; shih sidomos A. Kostallari, *Rreth një pikëpamjeje të Jeronim de Radës për formimin e gjuhës letrare të kombit shqiptar*, "Studime filologjike", nr. 3, 1981, f. 33-46. Kundrejt kritikave të bashkëkohësve për idenë e tij për të vënë si model të gjuhës një dialekt të veçantë, sidoqoftë De Rada përgjigjej se "nuk është fjala për një dialekt, por për një gjuhë të shënuar nga dialekte të veçanta, theksoj unë, pasi ngulimet e shpërndara në krahinat jugore kanë prejardhje të ndryshme", khs. G. De Rada, *Grammatica della lingua albanese*, Firenze, 1870, f. 56.

⁵⁵ Z. Jubani, *Kundërime mbi gjendjen morale e mbi kulturën intelektuale të popullit shqiptar*, në "Vepra të zgjedhuna", vep. cit., f. 79 (përkthyer nga J. Kastrati).

⁵⁶ Shih edhe A. Omari, "Figura të shquara katolike me vizion kombëtar në çështje të gjuhës: nga Zef Jubani te Luigj Gurakuqi", *Hylli i Dritës*, nr. 1-2, Shkodër, 2013, f. 51-59.

⁵⁷ S. Frashëri, *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë*, në: *Vepra 2*, Rilindja, Prishtinë, 1978, f. 63. (Botuar së pari në Bukuresht, 1899). Khs. edhe f. 79: "M'e par' e këtyre është gjuha; s'munt të ketë Shqipëri pa Shqipëtar, s'munt të ketë Shqipëtar pa gjuhë shqip, s'munt të ketë gjuhë shqip pa shkronja shqipe e pa shkolla, në të cilat të mësohetë shqipja".

gjuhë të përbashkët e cila do të krijohet në kryeqytetin e ardhshëm të Shqipërisë me përzjerjen e të folmeve të ndryshme të banorëve të ardhur nga të katër anët e vendit.⁵⁸ Samiu, ashtu si dhe rilindasit e tjerë, i shihte si një komb i vetëm shqiptarët gegë e toskë, dhe për sa i përket gjuhës, ata “flasinë një gjuhë me fort pakë të ndruarë, të cilëtë do të ngrihetë fare për s’afri duke ndërtuarë gjuha”⁵⁹.

Në periudhën e Lidhjes së Prizrenit, si një fillesë formacioni shtetëror autonom shqiptar të krijuar nga ndërgjegja kombëtare e shqiptarëve, doli si një nga nevojat më të ngutshme çështja e një alfabeti të njësuar për shkrimin e shqipes, gjë që u realizua me krijimin e alfabetit të Stambollit. Në këtë periudhë veprimtarët e Rilindjes shtruan nevojën edhe të një gjuhe të përbashkët⁶⁰. Në një letër që i drejton De Radës bashkë me Jani Vreton dhe Naim Frashërin, Sami Frashëri shkruante: “Lidhja Shqiptare kërkon bashkimin e Shqipërisë në një vilajet autonom”. Krahas bashkimit politik Samiu shtronte edhe çështjen e gjuhës së përbashkët: “Një gjuhë shqipe e pandame dhe e njëjtë na duhet se shumë gjuhë e dialekte sjellin ndarje e mërgim. Gjuha shqipe do të bëhet e begatë, e gjerë e do të shpëtonjë nga të pasurit nevojë me fjalë të huaja dhe gjithë dialektet do të gjenden të bashkuara e të përzjera.”⁶¹

Çështjen e gjuhës letrare shqipe do ta trajtonte më pas në mënyrë sistematike Faik Konica në revistën Albania, që në numrin e parë të saj më 1897, me rubrikën “Për themelin e nja gjuhës letrarishtes shqip”.

Përfytyrimi i rilindasve për gjuhën letrare kombëtare shqipe ishte krijimi i saj nga një përzgjedhje e të folmeve të ndryshme krahinore, që do ishte produkt i punës krijuese të lëvruarëve të gjuhës. Këtë ide e pati një kohë Kamarda, i ndikuar nga procesi i formimit të gjuhës letrare italiane, i cili përgatiti edhe një antologji me tekste të zgjedhura shqipe për të bërë të njohur modelet gjuhësore të anëve të ndryshme të hapësirës shqiptare⁶². Kamarda ndërmoi madje edhe nismën vetjake për të krijuar një gjuhë të përbashkët

⁵⁸ Po ai, *Vepra 2*, vep. cit., f. 85.

⁵⁹ S. Frashëri, *Vepra 2*, vep. cit., f. 47.

⁶⁰ Shih edhe A. Omari, “Ideja kombëtare në themel të përpjekjeve për një gjuhë të përbashkët letrare shqipe”, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë dhe U. i Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji, Seminari XXXIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Materialet e punimeve të Seminarit XXXIII, Prishtinë, 18-30.08.2014, Prishtinë, 2015, f.325-334.

⁶¹ *Një letër e Sami Frashërit mbi Lidhjen e Prizrenit*, në “Buletin për shkencat shoqërore”, Tiranë, 1954, II, f. 114-116.

⁶² *Vepra Appendice al saggio de grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Prato, 1866; khs. idetë e tij për gjuhën letrare shqipe në *Discorso preliminare*, f. VIII, XI.

letrare, mbidialektore, me rastin e përkthimit në shqip të një studimi të Dora D'Istrias, botuar në frëngjisht në vitin 1866⁶³. Për këtë qëllim ai lexoi e studioi tekstet e vjetra shqipe dhe gjuhën tyre, si dhe gjithë çka ishte botuar në shqip deri në atë kohë⁶⁴, dhe përdori atë lëndë dialektore që i dukej më e mira, më e fishta e më e pastra shqipe⁶⁵. Edhe Faik Konica në fillimet e revistës Albania kishte mendimin se gjuha letrare duhet krijuar me lëndën e nëndialekteve të ndryshme, sipas disa rregullave të caktuara⁶⁶. Sipas kësaj ideje disa rilindas shkruanin në një gjuhë të përzier, si Jani Vreto⁶⁷, Samiu dhe Naimi, vetë Konica në fillimet e revistës Albania, Luigj Gurakuqi⁶⁸ etj.

Me kalimin e kohës, kur u bë e qartë se shkrirja e dialekteve në një nuk kishte gjasa të ndodhte në një kohë të parashikueshme, veprimtarët dhe filologët pasrilindas ndërruan mendim lidhur me gjuhën e përbashkët të shkrimit dhe u përqendruan në një dialekt natyror si bazë e gjuhës së shkrimit, në hullinë e idesë së Zef Jubanit, të Kamardës e të Konicës për “gjuhën e mesme” ose të Elbasanit e rrethinave të tij si e folmja më e bukur e më e pastër shqipe dhe njëkohësisht si “urë midis dialekteve”, ku përziheshin elemente të të dy dialekteve të shqipes.

Megjithëse përpjekjet për krijimin e vullnetshëm të një gjuhe të përbashkët nga përzierja dialektore u treguan të pasuksesshme, përpjekjet e përbashkëta afatgjata të pararendësve të Rilindjes, të vetë rilindasve dhe të të gjithë shkrimtarëve të mëvonshëm, që u ndikuan nga ideja e një gjuhe letrare mbidialektore me pjesëmarrjen e të dy kryedialekteve të shqipes, kontribuan

⁶³ Dora D'Istria, *La nationalité albanaise d'après les chants populaires*, në: “Revue des deux mondes”, Paris, 1866.

⁶⁴ D. Camarda, *Prékallëzimë*, në: Dora D'Istria, *Fylétia e Arbënore prej kanëkatë laoshima*, enkëthyeme në shkjipte përej D. Camarda, Në Livurnë, te tipografia e P. Vannini e të Biritë, 1867, f. X.

⁶⁵ Shih më hollësisht për gjuhën letrare të krijuar nga Kamarda A. Omari, *Fillesat e idesë për një gjuhë të përbashkët letrare shqipe*, në: “Një rilindje para Rilindjes”, art. i cit., f. 257-260.

⁶⁶ “Për themelin e nja gjuhës letrarishtes shqip”, Albania, nr. 1, 1897, f. 4-5: “Është dhe vërtet që, veç munt Elbasanishtes, as nja nënëgjuhë ka miaft qëruari për me u-lartuem në krye të tjerave. Andaj duhet të marim pakë nga të tëra nënëgjuhërat; dhe jo të marim si të bjerë, po mbas këtyre kanuneve...”. Shih edhe Kristina Jorgaqi, hyrje studimore në: *Faik Konica, Mendime gjuhësie*, Ombra GVG, Tiranë, 2006, f. 16.

⁶⁷ Sh. Demiraj, *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, Universiteti i Prishtinës, 1970, f. 63-66, 68-69v. Shih edhe O. Myderrizi, *Çështja e zanores ë në ortografinë tonë*, “Buletin i USHT”, nr. 4, 1955, f.220.

⁶⁸ Lek Gruda, *Për themelin të një gjuhe letrëtare*, Albania, IX, 12, 132, 217, në “Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes kombëtare shqiptare” (përmbledhje artikujsh nga shtypi), përg. nga Zihni Haskaj, vëll. I, Universiteti i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1971, f. 288.

në formimin e një gjuhe letrare të përpunuar e të pasuruar me lëndë gjuhësore nga e gjithë hapësira mbarëshqiptare. Ndër këto përpjekje duhet dalluar veprimtaria e vetëdijshme e “babait të gjuhës shqipe”, Konstandin Kristoforidhit, për lëvrimin e të dy dialekteve dhe përpjekjet për afrimin e tyre në shkrim, si një kontribut i padiskutueshëm në rrugën e bashkëveprimit ndër dialektor të shqipes.

Letërsia kombëtare e shekullit XX, e formuar me kontributin e elementeve të të gjitha qarqeve letrare parakombëtare shqiptare⁶⁹, u bë edhe baza e dy varianteve të gjuhës letrare kombëtare, koinesë letrare toske dhe variantit letrar të gegërishtes me dy bashkëvariante, që konkurruan dhe bashkëvepruan edhe gjatë shekullit XX deri në sanksionimin e toskërishtes letrare si gjuhë standarde e shtetit shqiptar dhe e gjithë hapësirës shqipfolëse në Ballkan.

BIBLIOGRAFI

- A. Ducek, *Albania, Serbia and Bulgaria*, në “The New Cambridge Medieval History”: Volume 5, C: 1198-c. 1300, ed. by D. Abulafia, Cambridge University Press, 1999.
- A. Kostallari, *Rreth një pikëpamjeje të Jeronim de Radës për formimin e gjuhës letrare të kombit shqiptar*, “Studime filologjike”, nr. 3, 1981, f. 33-46.
- A. Meksi – D. Komata, *Kisha e Shën Mërisë së Brrarit*, “Iliria”, nr. 2, 1987.
- A. Omari, “Figura të shquara katolike me vizion kombëtar në çështje të gjuhës: nga Zef Jubani te Luigj Gurakuqi”, *Hylli i Dritës*, nr. 1-2, Shkodër, 2013, f. 51-59.
- A. Omari, “Ideja kombëtare në themel të përpjekjeve për një gjuhë të përbashkët letrare shqipe”, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë dhe U. i Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji, Seminari XXXIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Materialet e punimeve të Seminarit XXXIII, Prishtinë, 18-30.08.2014, Prishtinë, 2015, f.325-334.
- A. Omari, *Fillesat e idesë për një gjuhë të përbashkët letrare shqipe*, në “Një rilindje para Rilindjes”, Konferencë shkencore ndërkombëtare albanologjike, Universiteti “Eqrem Çabej” i Gjirokastrës, Gjirokastrë, 2014, f. 247-261.
- A. Omari, *Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe*, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2012.

⁶⁹ E. Çabej, *Për gjenezën e literaturës shqipe*, “Hylli i Dritës”, vjeti XV (1939), nr. 3-7, f. 180.

- A. Soloviev, *Eine Urkunde des Panhypersebastos Demetrios megas archon von Albanien*, "Byzantinische Zeitschrift", 1934.
- Anonymi Descriptio Europae Orientalis*, ed. O. Gorka, Cracoviae, 1916.
- C. Jireček, *Byzantinische Zeitschrift*, 13. Band (1904).
- C. Jireček, M. Šufflay, *Illyrisch-albanische Forschungen*, zusammengestellt von dr. Ludwig von Thalloczy. I Band, Verlag von Düncker & Humblot, München und Leipzig, 1916.
- D. Camarda, *Appendice al saggio de grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Prato, 1866.
- D. Camarda, *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Livorno, 1864,
- D. Camarda, *Prékallëzimë*, në: Dora D'Istria, *Fylétia e Arbënore prej kanëkatë laoshima*, enkëthyeme në shkjipte për D. Camarda, Në Livurnë, te tipografia e P. Vannini e të Biritë, 1867.
- D. D'Istria, *La nationalité albanaise d'après les chants populaires*, në: "Revue des deux mondes", Paris, 1866.
- Dh. Shuteriqi, *Anonimi i Elbasanit. Shkrimi shqip në Elbasan në shekujt XVIII-XIX dhe Dhaskal Todhri*, në: "Buletin i Institutit të Shkencave", nr. 1, Tiranë 1949, f. 33-54.
- Dh. Shuteriqi, *Dhaskal Todhri*, "Buletin i Institutit të Shkencave", nr. 4, Tiranë, 1954, f. 35-55.
- Dh. Shuteriqi, *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, ASHSH, IGJL, Tiranë, 2005.
- E. Çabej, *Pesëqindvjetori i shkrimit shqip. Kuvendi kishtar i Matit i vitit 1462 dhe Formula e Pagëzimit*, në "Studime Gjuhësore" VI, Rilindja, Prishtinë, 1977.
- E. Çabej, *Për gjenezën e literaturës shqipe*, "Hylli i Dritës", vjeti XV (1939), nr. 3-7.
- F. Konica, *Për themelin e nja gjuhës letrarishtes shqip*, "Albania", nr. 1, 1897.
- G. De Rada, *Grammatica della lingua albanese*, Firenze, 1870.
- G. Schirò, *Visita a Scutari di Michele Apostolio nel 1467*, "Zeitschrift für Balkanologie", 2 (1964).
- Historia e Shqipërisë*, I, USHT, Tiranë, 1959.
- I. Zamputi, *Dy mbishkrimet e fillimit të shek. XIII dhe lidhjet e tyre me principatën e Arbërit*, "Hylli i Dritës", 1995, 3-4.
- I. Zamputi, *Rindërtimi i mbishkrimit të Arbërit dhe mundësitë e reja për leximin e tij*, "Iliria", viti 1984, nr. 2, f. 207-218.
- J. G. Hahn, *Albanesische Studien*, Jena, 1854.
- J. Kastrati (përg.), *Zef Jubani, Vepra të zgjedhuna*, Tiranë, 1966,
- J. P. Migne, *Patrologia latina*, vol. 215, kol. 1334-1344.

- J. Rrota, *Per rreth botimit të dorëshkrimit shqyp të shekullit XIV*, “Hylli i Dritës”, nr. 7-8, 1930.
- K. Jireček, *Historia e serbëve*, Sh.B. 55, Tiranë, 2010.
- K. Jorgaqi, *Faik Konica, Mendime gjuhësie*, Ombra GVG, Tiranë, 2006.
- L. Gruda, *Për themelim të një gjuhe letrëtare*, “Albania”, IX, 12, 132, 217, në: “Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes kombëtare shqiptare” (përmbledhje artikujsh nga shtypi), përg. nga Zihni Haskaj, vëll. I, Universiteti i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1971.
- L. Thalloczy, C. Jireček, E. Sufflay, *Acta et Diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, Vindobonae, 1913.
- M. Šufflay, *Die Kirchengustände in vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchszone im Katholischen Damme*, në: “Illyrisch-albanische Forschungen”, München, 1916.
- M. Shuflaj, *Qytetet dhe kështjellat e Shqipërisë kryesisht në Mesjetë*, Onufri, Tiranë, 2009.
- N. Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, Botime Përpjekja, Tiranë, 2009.
- O. Myderrizi, *Çështja e zanores ë në ortografinë tonë*, Buletin i USHT, nr. 4, 1955.
- O. Schmitt, *Arbëria Venedike*, K&B, 2007.
- P. Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, Pegi, Tiranë, 2006.
- P. Xhufi, *Jeta politike në Shqipëri*, në: S. Anamali et. al., “Historia e popullit shqiptar”, I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Toena, Tiranë, 2002.
- R. Elsie, *Dorëshkrimi elbasanas i Ungjijve, 1761, dhe lufta për krijimin e një alfabeti shqiptar*, “Studime”, nr. 1, ASHAK, Prishtinë, 1994.
- R. Nachtigall, *Die Frage einer einheitlichen albanischen Schriftsprache*, Graz, 1917.
- R. Nahtigal, *O elbasanskem pismu i pismenstvu na njem*, “Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju”, I, Beograd, 1924.
- S. Anamali et. al., *Historia e popullit shqiptar*, I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Toena, Tiranë, 2002.
- S. Frashëri, *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë*, në: “Vepra 2”, Rilindja, Prishtinë, 1978.
- Sh. Demiraj, *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 1970.
- Xh. Lloshi, *W. Martin-Leake për shqiptarët dhe gjuhën shqipe*, studim hyrës në: W. Martin-Leake, *Kërkime për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe*, përkthyer dhe paraqitur nga Prof. Xhevat Lloshi, Bota Shqiptare, 2006.

Xh. Ylli, *Das slavische Lehngut im Albanischen*, München, 1997.

Z. Jubani, *Kundrime mbi gjendjen morale e mbi kulturën intelektuale të popullit shqiptar*, në “Vepra të zgjedhuna”, Tiranë, 1966.

SUMMARY

FROM THE BEGINNINGS OF ALBANIAN WRITING TO THE IDEA OF A COMMON LITERARY LANGUAGE

In this essay the author traces back the conception of the idea of a common Albanian literary language. On this occasion the analysis contemplates the cultivation of the Albanian language at different stages of its writing history since the beginning of writing in Albanian until the Renaissance period, when conditions were created for the need of a common language for all Albanians as a main motive for national awakening. This is done in connection with the circumstances of political and social history of each period and based on the cultural-literary areals of Albanian (after Çabej's classification of Albanian literature). The author concludes that for the first time the explicit idea of a common literary language was suggested by the Italo-Albanian intellectuals Demetrio Camarda (1864, 1866) and Girolamo de Rada (1847, 1870), then by the Albanian Renaissance activists Zef Jubani (1871, 1877) and Sami Frashëri (1899). Additionally, this essay considers the status of the Albanian language in its preliterate period at the time of the first Albanian state formations, such as the Principality of Arbanon (1190-1255), where the official and cultural languages were Greek and Latin; however, some indirect data are reported here on the use of local language in religious teaching, based on a document of Pope Innocent III.